



Oda e Farmacistëve të Kosovës - OFK

Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare
për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2018, 2017 dhe 2016

PËRMBAJTJA

FAQE

RAPORTI I AUDITORIT

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

1

PASQYRA E TË ARDHURAVE

2

PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË

3

SHËNIMET E PASQYRAVE FINACIARE

4-12



RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Menaxhmentit të Odës së Farmacisteve të Kosovës - OFK

Opinionit i Auditorit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Odës së Farmacisteve të Kosovës - OFK (tash e tutje referuar si OFK), të cilat përfshijnë Pasqyrën e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2018, 2017 dhe 2016 si dhe Pasqyrën e të Ardhurave, Pasqyrën e Ndryshimeve në Ekuitet, Pasqyrën e Rrjedhjes së Parasë për vitin e përmbyllur dhe të shënimeve tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, përveç çështjeve që përmenden në paragrafin e mëposhtëm, pasqyrat financiare të bashkangjitura paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të OFK më 31 dhjetor 2018, 2017 dhe 2016 dhe rezultatin e aktivitetit të saj për fundin e vitit, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për Raportim Financiar.

Baza për Opinion

Të hyrat nga anëtarësia

Gjatë procesit të auditimit dhe siç është prezentuar në notën 6 ne kemi vërejtur se ka pas dobësi në kontrolla përsa i përket të hyrave nga anëtarësia. Nga një mostër prej 116 raste të kontrolluara, kemi vërejtur se në 12 raste ka munguar dëshmia e pagesës në bankë për anëtarësinë e vitit 2018 edhe pse në dokumentin intern 'Të hyrat nga anëtarësia' personat në fjalë janë evidentuar se kanë pasur të paguara obligimet e anëtarësisë për vitin 2018. Nuk përjashtohet mundësia që këta anëtarë të kenë shlyer obligimet në vitin 2019 (që ka qenë përtej fushëveprimit tonë), por në këtë rast nuk kemi evidenca të sakta se sa kanë qenë llogaritë e arkëtueshme në fund të viteve 2018 dhe 2017 si dhe nuk është aplikuar vendimi i datës 31.08.2018 nga Këshilli Drejtues e që ka të bëjë me pagesat e antarësisë. Në vendim thuhet 'pagesat e antarësisë' për vitin duhet të realizohen deri më 31 dhjetor të vitit përkatës, në të kundërtën do të aplikohen masa disiplinore konform nenit 25 të ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetsor. Gjatë procesit të auditimit ne nuk kemi vërejtur se masa të tilla janë aplikuar në bazë të vendimit.

Shpenzimet e Pagave

Si pjesë e angazhimit të auditimit ne kemi kontrolluar edhe shpenzimet e pagave. Gjatë kontrollimit të këtyre testeve ne kemi vërejtur se disa anëtarë të komisioneve janë paguar në bazë të një liste të nënshkruar nga pjesëmarrësit por nuk kemi gjetur ndonjë dëshmi apo procesverbal të mbledhjeve të mbajtura.

Gjithashtu ne kemi vërejtur dy vendime të Kuvendit që kanë implikime të drejtpërdrejta në shpenzimet e pagave: me datën 30.03.2017 Kuvendi ka lëshuar dy vendime që janë në kundërtënie me njëra-tjetrën, më saktësisht pika 6 e këtij vendimi. Kjo ka shkaktuar edhe implikime financiare pasi që njëri version i vendimit iu është vënë në dispozicion kontabilistit për kalkulimin e pagave.

Në Shtator të vitit 2019 është marrë vendimi që kompensimi të bëhet retroaktivisht në bazë të paragrafit ku saktëson se meditet prej 25€ neto dhe në bazë të këtij vendimi është bërë korigjimi për kompensimet e vitit 2018 për anëtar të komisioneve.

Për më tepër vendimi është marrë në vitin 2017, më saktësisht pika e 11/15 (varësisht se cilit dokument i referohemi) thotë që ky vendim duhet të zbatohet retroaktivisht. Në bazë të këtij vendimi edhe tash në 2019 kurdo që paraqitet nevoja bëhen korigjime retroaktive të lëshimeve në kompensimin e antarëve të komisioneve.

Në lidhje me shpenzimet e pagave ne kemi vërejtur se ka edhe mospërputhje në mes të listave interne të pagave dhe atyre që janë deklaruar për qëllime tatimore.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodit IESBA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe atyre të ngarkuar me Qeverisjen e Pasqyrave Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar dhe për kontrollin e brendshëm të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së kompanisë për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likuoidojë Kompaninë apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativ tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë. Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezultojnë nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- I kuptojmë kontrollin e brendshëm relevante për auditimin me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshëm të Kompanisë.
- I vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruar të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e kompanisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri material ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në

raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojë që kompania të pushojë së vazhduari në vijimësi.

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisje lidhur me, në mesin e çështjeve tjera, qasjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.

ACA – Audit & Consulting Associates
Prishtinë, Kosovë
Shtator 2019

Odës së Farmacisteve të Kosovës - OFK
Pasqyra e Pozicionit Financiar
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2018, 2017 dhe 2016

		Më 31 dhjetor 2018 (në EUR)	Më 31 dhjetor 2017 (në EUR)	Më 31 dhjetor 2016 (në EUR)
ASETET				
Asetet qarkulluese				
Paraja dhe gjendja në banka	4	60,466	85,082	2,292
Llogaritë e arkëtueshme		-	-	-
Totali i aseteve qarkulluese		60,466	85,082	2,292
TOTALI I ASETETEVE		60,466	85,082	2,292
DETYRIMET DHE EKUITETI				
Detyrimet rrjedhëse				
Llogaritë e pagueshme	5	9,124	408	-
Totali i detyrimeve rrjedhëse		9,124	408	-
Ekuiteti				
Saldoja e bartur		84,674	2,292	-
Net (deficiti)/suficiti i vitit		(33,331)	82,382	2,292
Totali i ekuitetit		51,343	84,674	2,292
TOTALI I DETYRIMEVE DHE EKUITETIT		60,466	85,082	2,292

Pasqyrat financiare janë nënshkruar në shtator 2019 nga:

Arianit Jakupi

 Kryetar

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 9 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

Odës së Farmacisteve të Kosovës - OFK
Pasqyra e të Ardhurave
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2018, 2017 dhe 2016

	Shënimi	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2018 (në EUR)	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2017 (në EUR)	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2016 (në EUR)
Të hyrat				
Të hyrat	6	132,608	114,366	2,300
Totali i të hyrave		132,608	114,366	2,300
Shpenzimet				
Shpenzimet e pagave	7	91,358	29,382	-
Shpenzimet administrative	8	56,013	1,895	8
Shpenzimet tjera	9	18,568	707	-
Totali i shpenzimeve		165,939	31,983	8
Pjesa e mbetur		(33,331)	82,382	2,292

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 9 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

Odës së Farmacisteve të Kosovës - OFK
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2018, 2017 dhe 2016

	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2018 (në EUR)	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2017 (në EUR)	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2016 (në EUR)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operuese			
Mbetja gjatë operimit	(33,331)	82,382	2,292
Rregulluar për:			
Ndryshimet në të arkëtueshmet	-	-	-
Ndryshimet në të pagueshme	8,715	408	-
Paratë e gjeneruara nga operimet	(24,616)	82,790	2,292
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerja e pronës dhe e paisjeve			
Zvogelim i kapitalit	-	-	-
Paraja neto e përdorur në investime	-	-	-
Ndryshimet neto në para dhe ekuivalent	(24,616)	82,790	2,292
Paraja dhe ekuivalentet e parasë më 1 Janar	85,082	2,292	-
Paraja dhe ekuivalentet më 31 Dhjetor	60,466	85,082	2,292

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 9 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

Odës së Farmacistëve të Kosovës - OFK
Shënimet e pasqyrave financiare
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2018, 2017 dhe 2016

1. Hyrje

Oda e Farmacistëve të Kosovës është organizatë e pavarur e cila mbron dhe prezanton interesat profesionale të anëtarëve të saj, siguron standardet e larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbronë veprimtarinë e profesionistëve shëndetësorë në institucionet shëndetësore publike dhe private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ofrimit sa më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Misioni dhe Visioni

Misioni dhe visioni i Odës së Farmacistëve të Kosovës është profesionalizmi dhe siguria e përdorimit të barnave.

Odës së Farmacisteve të Kosovës - OFK
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2018, 2017 dhe 2016

2. ADAPTIMI I STANDARTEVE TË RISHIKUARA DHE STANDARDEVE TË REJA

2.1 Standardet, amendamentimet dhe interpretimet efektive në këtë periudhë

Më poshtë janë paraqitur ndryshimet në standardet ekzistuese të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimit Financiar të cilat janë në fuqi për periudhën aktuale:

Standardi	Përshkrimi	Data efektive
Amandament në SNRF 10	Pasqyrat Financiare të Konsoliduara	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016
Amandament në SNRF 11	Dhënia e informacioneve shpjeguese tek subjektet tjera të interesit – udhëzues i Tranzicionit	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016
Amandament në SNRF 12	Dhënia e informacioneve shpjeguese tek subjektet tjera të interesit	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016
Amandament në SNK 1	Prezentimi i pasqyrave financiare	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016
Amandament në SNK 7	Iniciativa të shpalesjeve	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2017
Amandament në SNK 12	Njohja e tatimeve të shtyra për Humbjet e perealizuara	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2017
Amandament në SNK 16	Sqarime të metodave të pranueshme të zhvlerësimit dhe amortizimit	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016
Amandament në SNK 27	Ndryshime për të rivendosur metodën e ekuitetit si opcion kontabël në pasqyrat e ndara	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016
Amandament në SNK 28	Ndryshimet në lidhje me shitjen ose kontributin e aseteve në mes të një investitori, bashkëpunëtori apo joint venture	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016
Amandament në SNK 38	Asetet e paprekshme	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016
Amandament në SNK 41	Impiantet bartëse	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016
Amandamentimet në standarde të ndryshme	Përmirësimet në SNRF (të ciklit 2012-2014) - që rezultojnë nga Projekti i Përmirësimit vjetor të SNRF (SNRF 5, SNRF 7, SNK 19 dhe SNK 34) kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin	periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 Janar 2016

Odës së Farmacisteve të Kosovës - OFK
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2018, 2017 dhe 2016

Amandamentimet në standarde të ndryshme	Përmirësimet në SNRF (të ciklit 2012-2014) - që rezultojnë nga Projekti i Përmirësimit vjetor të SNRF (SNRF 2, SNRF 2, SNRF 8, SNRF 13, SNK 16 dhe SNK 38) kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2014
Amandamentimet në standarde të ndryshme	Përmirësimet në SNRF (të ciklit 2011-2013) - që rezultojnë nga Projekti i Përmirësimit vjetor të SNRF (SNRF 1, SNRF 3, SNRF 13 dhe SNK 40) kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin	periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 Korrik 2014

2.2 Standardet, amendamentimet dhe interpretimet jo efektive në këtë periudhë

Në këto pasqyra financiare, standardet, rishikimet dhe interpretimet e mëposhtme akoma nuk janë efektive:

Standardi	Përshkrimi	Data efektive
SNRF 3	Përmirësimet në SNRF (të ciklit 2015-2017) - që rezultojnë nga Projekti i Përmirësimit vjetor, kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019
SNRF 16	Qiratë	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019
SNRF 17	Kontratat e Sigurimeve	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2021
SNRF 9	Instrumentet Financiare Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019
SNK 1	Paraqitja e Pasqyrave Financiare	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2020
SNK 8	Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2020
SNK 19	Përfitimet e Punonjësve	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019
Ndryshimet në standarde të ndryshme	Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2015-2017)	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019

Odës së Farmacisteve të Kosovës - OFK
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2018, 2017 dhe 2016

KIRFN 23	Pasiguria mbi Trajtimin e Taksave mbi të Ardhurat	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019
SNFR 11	Përmirësimet në SNRF (të ciklit 2015-2017) - (rivlerësimi i interesit të mbajtur më parë)	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019
SNRF 9	Vetitë e parapagimive me kompensim negativ dhe modifikimet e detyrimeve financiare	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2018
SNFR 11	Përmirësimet në SNRF (të ciklit 2015-2017) - (rivlerësimi i interesit të mbajtur më parë)	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019
SNRF 15	Sqarime rreth SNRF 15	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2018
SNRF 16	Qeratë	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019
SNRF 17	Qeshtje Origjinale	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2021
SNK 19	Amandement në lidhje me ndryshimet në planifikim, kufizimet ose rregullimet	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019
SNK 28	Përmirësimet në SNRF (të ciklit 2014-2016) - (qartësim i matjeve të vlerës së drejtë)	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2018

Organizata ka vendosur të mos i adaptojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre. Biznesi parashikon që adaptimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të subjektit në periudhën e zbatimit fillestar.

Odës së Farmacisteve të Kosovës - OFK
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2018, 2017 dhe 2016

3. BAZA E PËRGATITJES DHE POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

3.1 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare të bashkangjitura janë përgatitur për qëllime të raportimit në përputhje me ligjet e aplikueshme në Kosovë, dhe paraqesin një pasqyrë të plotë të ngjarjeve ekonomike që kanë ndodhur në OFK në vitin 2018, 2017 dhe 2016.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të modifikuar të parave të gatshme, në bazë të cilit të ardhurat dhe shpenzimet njihen në momentin kur kanë ndodhur ose janë paguar, përveç në raste të veçanta. Organizata përdorë aplikacionin Pro Data për përgatitjen e pasqyrave financiare.

3.2 Valuta e përdorur

Raportimi i transaksioneve të ndodhura të "OFK" është bërë në Euro ("EUR").

3.3 Politika të rëndësishme kontabël

Një përmbledhje e politikave më të rëndësishme kontabël të zbatuara në përgatitjen e pasqyrave financiare është paraqitur më poshtë:

3.3.1 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentet e parasë janë konsideruar të jenë paraja në llogari rrjedhëse, si dhe paraja me maturitet jo më shumë se tre muaj.

3.3.2 Të hyrat

Të hyrat nga anëtarësia, licencimet dhe rilicencimet njihen në momentin kur te pranohen mjetet. Në fund të vitit sasia e tepërt e të ardhurave krahas shpenzimeve trajtohen si bilanc i bartur në periudhën e ardhshme.

3.3.3 Njohja e shpenzimeve

Shpenzimet e ndodhura janë njohur në periudhën përkatëse në baza të keshit.

3.3.4 Tatimet

OFK u themelua si një organizatë e pavarur profesionale sipas ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor me numër 04/L-150, për këtë arsye ka përgjegjësi dhe vepron si e tillë sipas ligjeve të Kosovës në fuqi.

Odës së Farmacisteve të Kosovës - OFK
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2018, 2017 dhe 2016

4. PARAJA DHE GJENDJA NË BANKË

	Më 31 dhjetor 2018 (në EUR)	Më 31 dhjetor 2017 (në EUR)	Më 31 dhjetor 2016 (në EUR)
Paraja në bankë-NLB Bank	60,467	85,082	2,292
Totali parasë dhe gjendjes në bankë	60,467	85,082	2,292

Gjatë vitit 2016, 2017 dhe 2018 OFK ka përdorur llogarinë në NLB Bank për të gjitha hyrjet dhe daljet. Në fund të vitit 2018 kjo llogari kishte një gjendje prej 60,467 euro.

5. LLOGARITË E PAGUESHME

	Më 31 dhjetor 2018 (në EUR)	Më 31 dhjetor 2017 (në EUR)	Më 31 dhjetor 2016 (në EUR)
Llogarite e pagueshme - Furnitor	193	(104)	-
Detyrimi ndaj pagave	2,680	-	-
Detyrimi ndaj tatimit ne paga	1,311	227	-
Detyrimi ndaj kontributeve punetori	2,470	143	-
Detyrimi ndaj Kontributeve punedhenesi	2,470	143	-
Totali i llogarive të pagueshme	9,123	408	-

Odës së Farmacisteve të Kosovës - OFK
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2018, 2017 dhe 2016

6. TË HYRAT

	Më 31 dhjetor 2018 (në EUR)	Më 31 dhjetor 2017 (në EUR)	Më 31 dhjetor 2016 (në EUR)
Të hyrat nga Antarësimet	44,050	41,952	1,900
Të hyrat nga sponsorizimet	36,530	1,000	-
Të hyrat nga pjesëmarrja në konferencë	28,721	600	-
Të hyrat nga Licencimet	12,200	8,300	200
Të hyrat nga Rilicencimet	10,580	57,802	200
Të hyrat tjera	527	4,712	-
Total të hyrat	132,608	114,366	2,300

Shënim: Të gjitha kategoritë e të hyrave përfshirë edhe Të hyrat nga sponsorizimet dhe Të hyrat nga pjesëmarrja në konferencë janë regjistruar në bazë të raportit financiar dhe dëshmimeve përcjellëse dhe ne nuk kemi hasur në dëshmi relevante se ka pasur të hyra tjera në këto dy kategori për vitet 2018 dhe 2017.

7. SHPENZIMET PËR PAGA

	Më 31 dhjetor 2018 (në EUR)	Më 31 dhjetor 2017 (në EUR)	Më 31 dhjetor 2016 (në EUR)
Pagat bruto	87,007	27,983	-
Kontributet pensionale	4,351	1,399	-
Totali i pagave dhe përfitimeve	91,358	29,382	-

Odës së Farmacisteve të Kosovës - OFK
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2018, 2017 dhe 2016

8. SHPENZIMET ADMINISTRATIVE

	Më 31 dhjetor 2018 (në EUR)	Më 31 dhjetor 2017 (në EUR)	Më 31 dhjetor 2016 (në EUR)
Shpenzime për organizimin e konferencës	46,786	-	-
Materialet per zyre	6,910	-	-
Shpenzimet e telefonit	1,241	364	-
Shpenzimet bankare	716	330	8
Shpenzime për sigurim	360	-	-
Shpenzime për derivate	-	1,200	-
Shpenzimet totale administrative	56,013	1,895	8

9. SHPENZIMET TJERA

	Më 31 dhjetor 2018 (në EUR)	Më 31 dhjetor 2017 (në EUR)	Më 31 dhjetor 2016 (në EUR)
Shpenzimet e reklamave	3,241	187	-
Shpenzimet e udhëtimit	3,186	-	-
Shpenzimet e akomodimit	2,800	-	-
Shpenzime për këshillime	2,590	-	-
Shpenzime për anëtarësime	2,518	-	-
Shpenzimet për web	2,398	-	-
Shpenzimet e reprezentacionit	1,235	-	-
Donacionet	600	-	-
Shpenzimet e konferencave/seminareve	-	520	-
Shpenzimet totale tjera	18,568	707	-

Odës së Farmacisteve të Kosovës - OFK
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2018, 2017 dhe 2016

15. PALËT E NDËRLIDHURA

Për qëllime të këtyre pasqyrave financiare, palët konsiderohen të ndërlidhura nëse njëra prej tyre ka mundësinë të kontrolloj palën tjetër, apo nëse njëra prej tyre ka ndikim në palën tjetër gjatë marrjes së vendimeve financiare apo operuese sic është cekur ne SNK 24 (standardet ndërkombetare të kontabilitetit) "Shpalosja e palëve të ndërlidhura". Në vështrimin e mundësinë e ekzistimit të palëve të ndërlidhura, vëmendja është përqëndruar në aspektin e marrëdhënies e jo në aspektin legal.

16. MENAXHIMI I RISKUT

Kredit risku

Kredit Risku është risku që njëra palë me dështimin në përmbushjen e obligimeve financiare do ndikojë në palën tjetër të ketë humbje financiare. OFK nuk i është ekspozuar kredit riskut në aspektin e të hyrave nga donatoret.

Risku nga kamatat

OFK momentalisht nuk i është ekspozuar riskut nga kamatat bankare.

Risku nga këmbimet ndërkombëtare

OFK nuk i është ekspozuar rrezikut nga këmbimet ndërkombëtare pasi që transaksionet ndodhin në valutë vendore.

Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit paraqet riskun kur pjekuria e pasurisë dhe e detyrimeve nuk përputhen. OFK monitoron likuiditetin e saj në baza periodike, në mënyrë që të menaxhoj obligimet e saj në momentin kur duhet të paguhen.

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Vlera kontabël e të gjitha aseteve dhe detyrimeve financiare të reflektuara në pasqyrat financiare përfaqësojnë me vlerën e tyre reale.